

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Rafet Haxhaj dhe Isa Shala anëtarë, në çështjen juridike të paditësve A.H. dhe M.H. që të dy nga fshati .... Komuna e Dragashit të cilët i përfaqëson avokat F.C. nga ....., kundër të paditurve V.B., F.Ç, M.Ç dhe Ç.Ç që të gjithë nga fshati ... Komuna e Dragashit, të cilët i përfaqëson avokat R.B nga ..., në çështjen për kompensim dëmi të shkaktuar me caktimin e masës së përkohshme, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Dragash, C.nr.24/07 të datës 02.11.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10.03.2017**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pa themeltë** ankesa e paditësve A.H dhe M.H. që të dy nga fshati ..., Komuna e Dragashit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Dragash, C.nr.24/07 të datës 02.11.2012, **VËRTETOHET**.

**APROVOHET si e themeltë** ankesa e të autorizuarit të paditurve, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Dragash, C.nr.24/07, të datës 02.11.2012, sa i përket vendosjes si në pikën III. të dispozitivit, lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që: **OBLIGOHEN** solidarishtë paditësit A.H dhe M.H që të dy nga fshati Restelicë Komuna e Dragashit që të paditurve V.B, F.Ç, M.Ç dhe Ç.Ç që të gjithë nga fshati Restelicë Komuna e Dragashit në mënyrë solidare të ju paguajnë shpenzimet e procedurës, në shumën prej 900.00€ (nëntëqind euro) në afat prej 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr. 24/07 i datës 02.11.2012 , në pikën një të dispozitivit ka konsideruar se padia - kërkesëpafia e paditësve kundër të paditurit Ç.Çufta nga fshati ... Komuna e Dragashit është tërhequr. Në pikën dy refuzohet në tërsi kërkesëpafia e paditësve A.H. dhe M.H. nga fshati ... Komuna e Dragashit të cilët i përfaqëson i autorizuari avokat F.C nga Prizreni, kundër të paditurve V.B., F.Ç., M.Ç. dhe Ç.Ç. që të gjithë nga fshati ... Komuna e Dragashit, të cilët i përfaqëson me autorizim avokat R.B. nga ..., me të cilën kërkojnë që të aprovohet kërkesëpafia e paditësve dhe se të paditurit V.B., F.Ç., M.Ç. që të gjithë nga fshati ... , obligohen në mënyrë solidare që paditësve t'ia kompensojnë dëmin i cili është shkaktuar me rastin e paraqitjes së padisë për pengimin e të drejtës së kalimit zyrtar kurse me Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Dragash C.nr.57/06 të dt. 12.05.2006, dhe 26.05.2006, ju është urdhëruar që në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 3712 në vendin e quajtur "...” nga lista poseduese nr. 577 ZK ..., që të mos kryen punimet ndërtimore e as të linçojnë material ndërtimor, e cila ndalesë ka zgjatur krejt deri më datën 06.09.2006 – mbi 3 muaj vitin kur kanë marrë aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë të

Gjykatës së Qarkut në Prizren AC.nr.327/06 të datës 11.08.2006 e cila Aktvendimin e atakuar të Gjykatës Komonale në Dragash C.nr.57/06 të dt.12.06.2006 me të cilën kërkesëpadia e paditësve – këtu të paditurit kundër paditësve – këtu paditësve i është refuzuar si e pa bazë, dhe atë në shumën prej 6.700.00 €, sa i kanë paguar punëtorët sipas marrëveshjes me të cilën i është ndërprerë punimet dhe materiali i dëmtuar – rërës dhe çimentos për të dy objektet ndërtimore, e krejt në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të dhunshëm, dhe të paditurit të obligohen në mënyrë solidarë që paditësve të i paguajnë të gjitha shpenzimet në të njëjtin afat nën kërcënim. Në pikën tre me shpenzimet e procedurës obligohen paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesë brenda afatit ligjor paditësit A.H. dhe M.H., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e atakuar C.nr.24/07 të datës 02.11.2012, ta ndryshoj ashtu që kërkesëpadia e paditësve të aprovohet në tërësi, apo që i njëjti të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurve, avokat R.B. nga Prizreni, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që aktgjykimi i shkallës së parë, në pjesën e kundërshtuar përkritazi me vendimin e shpenzimeve procedurale, të ndryshohet ashtu që të detyrohen paditësit solidarisht t'iu kompensojnë të paditurve shpenzimet procedurale siç janë specifikuar në seancën e fundit të shqyrtimit kryesor të mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, duke shtuar edhe shumën prej 200,00€, për hartimin e kësaj ankese, ose atë ta prishi në këtë pjesë dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

- **Ankesa është e paditësve është pa themeltë**
- **Ankesa e të autorizuarit të paditurve është e themeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurit me kërkesë për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar duke u refuzuar kërkesëpadinë e paditësve, duke konsideruar se nuk ekzistojnë kushtet për aplikimin e nenit 154 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilat është thirrur pala në ankesë, si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës paditëse, sepse gjykata e shkallës

së parë në tërësi ju ka përmbajtur kërkesës së palës paditëse sipas padisë së precizuar nga i autorizuari i paditësve, e dorëzuar në gjykatë me datë 23.10.2012, andaj pretendimi se pala paditëse kanë kërkuar diçka tjetër e gjykata ka vendosur diçka tjetër, është i pa bazë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe se e njëjta me të drejtë ka refuzuar kërkesëpadinë, pasi nga shkresat e lëndës, provat e administruara në këtë çështje, nuk është vërtetuar se paditësit kanë pësuar dëm nga veprimet e të paditurve.

Nga provat e administruara dëgjimi i dëshmitarëve në këtë çështje A.A., H.R., L.H., Z. SH., Xh.I., si dhe nga ekspertiza e ekspertit M.A. të dhenë me shkrim dhe gjatë shqyrtimit kryesor, nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësve se është shkaktuar dëmi i kërkuar sipas kërkesëpadisë me caktimin e masës së përkohshme sipas Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Dragash C.nr.57/06 të dt. 12.05.2006, dhe 26.05.2006, andaj duke marrë parasysh arsyet e lartcekura, me të drejtë është refuzuar kërkesëpadia pasi bazuar në nenin 319, par.1, të Ligjit të procedurës kontestimore në bazë të cilit secila palë ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, si dhe nenit 322 të LPK-së, në bazë të së cilit në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat për barrën e provave, në rastin konkret gjykata me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë nuk ka mundur të vërtetojë se dëmi i pretenduar është shkaktuar, dhe as nuk është provuar se dëmi i pretenduar vërtet ka ndodhur me fajin e të paditurve, respektivisht se me veprimet e të paditurve është shkaktuar dëmi i pretenduar nga paditësit, si në kërkesëpadi.

Gjykata e apelit ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Dragash, C.nr.24/07, të datës 02.11.2012, sa i përket vendosjes si në pikën III. të dispozitivit, lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që ka obliguar solidarisht paditësit, ti kompensojnë shpenzimet e procedurës në bazë të nenit 452, par.1, të LPK-së, të paditurve në mënyrë solidare, në shumën prej 900.00€ (nëntëqind euro). Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar vetëm i ka obliguar paditësit me shpenzimet e procedurës, pa specifikuar shumën, por të njëjtat i ka arsyetuar duke i njohur të paditurve shpenzimet e procedurës për shpenzimet e përfaqësimit të autorizuarit për katër seanca nga 200 euro, dhe për përpilim të përgjigjes në padi në shumën prej 100 euro, të cilat shpenzime janë të arsyetuara në bazë të shkresave të lëndës, ndërsa përlllogaritja është e bazuar në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve, të cilat shpenzime janë të bazuara andaj gjykata ka ndryshuar dhe vendosur si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.443/2013, më datë 10.03.2017**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
*Fejzullah Rexhepi*